



VENDIM

Nr. 109, Datë 29.06.2016

MBI

**MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURAT DHE AFATET
PËR DHËNIEN, MODIFIKIMIN, TRANSFERIMIN, RINOVIMIN OSE
HEQJEN E LICENSAVE NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 20 dhe 39 të Ligjit nr.43/2015 „Për Sektorin e Energjisë Elektrike, nenit 26 të Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.06.2016, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga grupi i punës të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike dhe relacionin përkatës,

Vendosi:

1. Të miratojë Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike.
2. Të shfuqizojë vendimin Nr. 108, datë 09.09.2008, të Bordit të ERE.
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.